



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 525 Prot.

Tiranë, më datë 19.02.2020

VENDIM

Nr. 46, datë 19.02.2020

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 48 dhe neni 134 dhe V.K.M Nr.208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, pas shqyrtimit më parë të projektit të Bashkisë Durrës “Rehabilitimi i rrugës së “Dëshmorëve” nga kryqëzimi i sheshit “Pranvera”, deri te kryqëzimi me rrugën “Mujo Ulqinaku”, zona arkeologjike “B”, Durrës, në Këshillin Teknik të Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 19.02.2020,

VENDOSI:

1. Investitori të kontraktojë një subjekt të licencuar në arkeologji, për hartimin e konceptit të sondazheve arkeologjike, i cili do të kalojë për shqyrtim dhe vendimarrje në mbledhjen e radhës së KKTKM-së.
2. Ngarkohet Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore për regjistrimin e këtij Vendimi;
3. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
4. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Arta DOLLANI

KRYETAR

Elva MARGARITI

